



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1100
Dt 01.10.2015

Në bazë të nenit 48 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Për aprovimin e raporteve të komisioneve për angazhimin e stafit akademik në procesin mësimor për vitin akademik 2015-2016, sipas konkursit të datës 22.9.2015.
- II. Kontratat e punës për stafin e propozuar për angazhim sipas raporteve të komisioneve të njësive akademike do të përpilohen sipas dispozitave ligjore, nga organet kompetente.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet njoftimi mbi kandidatët e suksesshëm nga konkursi plotësues për angazhimin e stafit akademik për vitin akademik 2015/2016.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit për paga;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1120
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 48 dhe 49 të Statutit të Përkohshëm, nenit 4 të Marrëveshjes për ndarje mes MASHT-it, UP-së dhe UMIB-it, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Lejohet vazhdimi i kontratave të personelit akademik me titull ligjërues, të cilët kanë kaluar nga Universiteti i Prishtinës në Universitetin e Mitrovicës, prej 31.7.2015-30.9.2016.
- II. Me secilin ligjërues do të lidhet kontratë individuale me kushtet e njëjta siç kanë qenë të përcaktuara në kontratat e mëhershme, që i kanë pasur në Universitetin e Prishtinës.
- III. Ass. Arbërie Krasniqi, asistente e matematikës në FIMK, i vazhdohet kontrata në kushte të njëjta sikurse edhe ligjëruesve, d.m.th. prej 31.7.2015-30.9.2016.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 47 dhe 48 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it dhe në Marrëveshjen për ndarje mes MASHT-it, UP-së dhe UMIB-it, përkatësisht në nenin 4, pika 4, për bartjen e personalit akademik nga UP-ja në UMIB, si dhe duke pasur parasysh nevojën e mbarëvajtjes së procesit mësimor, e konsideroi të domosdoshëm vazhdimin e kontratave për këtë kategori të personelit akademik. Gjithashtu, edhe personeli nga pika III e këtij vendimi është kategori deficitare dhe ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nga sa u tha më sipër, Senati i Universitetit mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit për paga;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1121
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 48 dhe 49 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Personelit akademik të Universitetit të Mitrovicës me thirrje akademike profesor, asistent, asistent i ri ose lektor, që i ka skaduar kontrata, u vazhdohet kontrata e punës deri më 31.12.2015.
- II. Personelit akademik të Universitetit të Mitrovicës me thirrje akademike profesor, asistent, asistent i ri ose lektor, që i ka skaduar kontrata ose që u skadon kontrata deri më 31.12.2015, do tu shpallet konkursi për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje.
- III. Dekanët e njësive akademike janë të obliguar që të dërgojnë në Zyrën e Personelit në rektorat, listën e personelit akademik nga pika II e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit për paga;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1126
Dt 05.10.2015

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

I

1. Të gjitha njësitet akademike-fakultetet e Universitetit të Mitrovicës obligohen që të realizojnë mbajtjen e dy provimeve në muajin tetor.
2. Njësitet akademike janë të obliguara që të realizojnë edhe mbajtjen e provimeve në muajin nëntor, mars dhe maj për studentët e vitit të fundit-apsolventët.

II

Organizimi i mbajtjes së provimeve si në pikën I. 1 të këtij vendimi duhet të bëhet në muajin tetor, prej datës 1-15 tetor 2015, sipas orarit të cilin e përcaktojnë njësitet akademike-fakultetet. Organizimi i mbajtjes së provimeve si në pikën I. 2 të këtij vendimi duhet të bëhet në muajt përkatës, sipas orarit të cilin e përcaktojnë njësitet akademike-fakultetet.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1127
Dt 05.10.2015

Në bazë të kërkesës së Këshillit të Fakultetit të Gjeoshkencave, me nr. 1076, të datës 29.09.2015, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Ratifikohet procesverbali i dhënies së provimeve plotësuese nga studenti Bersant Beka, në studimet master në Departamentin Materiale dhe Metalurgji.
- II. I përmenduri fiton të drejtën e regjistrimit në studimet master në Fakultetin e Gjeoshkencave, në Departamentin Materiale dhe Metalurgji, në vitin akademik 2015-2016.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Shërbimit për çështje të studentëve të FGJ-së;
4. Shërbimit për çështje të studentëve të UMIB-it;
5. Të përmendurit;
6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1128
Dt 05.10.2015

Në bazë të kërkesës së Këshillit të Fakultetit të Gjeoshkencave, me nr. 1076, të datës 29.09.2015, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Ratifikohet procesverbali i dhënies së provimeve plotësuese nga studenti Gzim Ramiz Berisha, në studimet master në Departamentin Materiale dhe Metalurgji.
- II. I përmenduri fiton të drejtën e regjistrimit në studimet master në Fakultetin e Gjeoshkencave, në Departamentin Materiale dhe Metalurgji, në vitin akademik 2015-2016.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Shërbimit për çështje të studentëve të FGJ-së;
4. Shërbimit për çështje të studentëve të UMIB-it;
5. Të përmendurit;
6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rëktor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1129
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 48 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Për aprovimin e raporteve të njëjësive akademike për angazhimin e stafit akademik në procesin mësimor për vitin akademik 2015-2016.
- II. Kontratat e punës për stafin e propozuar për angazhim sipas raporteve të njëjësive akademike do të përpilohen sipas dispozitave ligjore, nga organet kompetente.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit për paga;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1130
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 18 të Rregullores mbi punën e Senatit, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9, mori:

VENDIM

I

1. Prof. asoc. dr. Behxhet Shala zgjidhet prodekan i Fakultetit të Gjeoshkencave të UMIB-it.
2. Prodekani i Fakultetit i kryen detyrat, në bazë të Statutit të Përkohshëm dhe akteve të tjera normative të Universitetit të Mitrovicës.
3. Mandati i prodekanit është i plotë (neni 4 i UA të MASHT-it 03/2015).

II

Prodekanit të Fakultetit i takon paga mujore, si dhe beneficionet e tjera, sipas Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor;
4. Shërbimit financiar;
5. Të përmendurit.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. MB1
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 18 të Rregullores mbi punën e Senatit, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9, mori:

VENDIM

I

1. Prof. ass. dr. Mensur Kelmendi zgjidhet prodekan i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore të UMIB-it.
2. Prodekani i Fakultetit i kryen detyrat, në bazë të Statutit të Përkohshëm dhe akteve të tjera normative të Universitetit të Mitrovicës.
3. Mandati i prodekanit është i plotë (neni 4 i UA të MASHT-it 03/2015).

II

Prodekanit të Fakultetit i takon paga mujore, si dhe beneficionet e tjera, sipas Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor;
4. Shërbimit financiar;
5. Të përmendurit.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1132
Dt 05.10.2015

Në bazë të nenit 18 të Rregullores mbi punën e Senatit, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9, mori:

VENDIM

I

1. Prof. ass. dr. Qamil Kabashi zgjidhet prodekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të UMIB-it.
2. Prodekani i Fakultetit i kryen detyrat, në bazë të Statutit të Përkohshëm dhe akteve të tjera normative të Universitetit të Mitrovicës.
3. Mandati i prodekanit është i plotë (neni 4 i UA të MASHT-it 03/2015).

II

Prodekanit të Fakultetit i takon paga mujore, si dhe beneficionet e tjera, sipas Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor;
4. Shërbimit financiar;
5. Të përmendurit.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1133
Dt 05.10.2015

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit Juridik për vazhdimin e procedurave të rregullta të rekrutimit për pozitën: Asistent për grup lëndësh nga lëmi penal.
- II. Shfuqizohet pjesërisht vendimi i Senatit me nr. prot. 1022, i datës 11.09.2015.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke pasur parasysh se, me vendimin e Senatit nr. prot. 1022 të datës 11.09.2015, është anuluar pozita: Asistent për grup lëndësh nga lëmi penal, në Fakultetin Juridik, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën koordinatorit të Fakultetit Juridik për vazhdimin e procedurave të rregullta të rekrutimit për këtë pozitë, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, pasi njësia akademike e vlerëson të domosdoshme këtë pozitë për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nga sa u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1134
Dt 05.10.2015

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike për pranimin e dokumentacionit të kandidatëve që kanë aplikuar në Fakultetin e Edukimit për pozitën: Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë I, Matematikë II, në bazë të konkursit për personel akademik të shpallur nga UMIB më 30.6.2015 dhe vazhdimin e procedurave të rregullta të rekrutimit për këtë pozitë në FIMK.
- II. Aplikacionet e kandidatëve që kanë konkurruar në Fakultetin e Edukimit për pozitën: Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë I, Matematikë II, në bazë të konkursit për personel akademik të shpallur nga UMIB më 30.6.2015 do të transferohen në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.
- III. Dekanati i FIMK-ut obligohet që për pozitën: Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë I, Matematikë II, në bazë të konkursit për personel akademik të shpallur nga UMIB për FIMK-un, të zbatojë procedurat e rregullta të rekrutimit të stafit për këtë pozitë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke pasur parasysh se, me vendimin e Senatit nr. prot. 1022 të datës 11.09.2015, është anuluar pozita: Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë I, Matematikë II, në Fakultetin e Edukimit, e ndërkohë për të njëjtën pozitë në FIMK nuk është paraqitur asnjë kandidat, e konsideroi të arsyeshme që aplikacionet e kandidatëve që kanë konkurruar në Fakultetin e Edukimit të shqyrtohen nga FIMK-u, sipas procedurave të rregullta statutare, për arsye se fakulteti ka nevojë urgjente për një kuadër të kësaj fushe dhe kjo do të ndihmonte në mbarëvajtjen e procesit mësimor, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1135
Dt 05.10.2015

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, mori:

VENDIM

I

Emërohet Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i Senatit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

II

Komisioni ka këtë përbërje:
Blerim Baruti,
Nushe Lajqi,
Ahmet Haxhijaj.

III

Komisioni është i obliguar të shqyrtojë ankesat dhe parashtrësat që i drejtohen Senatit të UMIB-it.

IV

Kryetari i komisionit është i obliguar që të thërrasë mbledhjet e komisionit dhe të japin propozime konkrete për mbledhjet e Senatit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Anëtarëve të Komisionit,
3. Shërbimit financiar,
4. Zyrtarit Ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Rektori i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1328
Dt 26.10.2015

Në bazë të nenit 25, pika 1 dhe 2, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, rektori i UMIB-it nxjerr:

VENDIM

- I. Për anulimin e pjesërisht të vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve që nuk janë pranuar në studime nga procesverbali me nr. prot. 1281 të datës 19.10.2015.
- II. Kandidatët: Vjollca Morina, Arbnora Bytyqi, Arta Lila Nuza, Anita Cernobregu Rrustemi dhe Besa Rexhepi nuk pranohen në studime master në FTU të UMIB-it.
- III. Kandidati: Muhamet Bajqinovci pranohet në vitin e parë të studimeve bachelor në Fakultetin e Edukimit të UMIB-it.

Arsyetim

Rektori i UMIB-it, pas shqyrtimit të procesverbalit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve që nuk janë pranuar në studime për vitin akademik 2015-2016 me nr. prot. 1281 të datës 19.10.2015, ka konstatuar se Komisioni i lartcekur nuk ka vendim valid të UMIB-it për të konstatuar se studimet master –drejtimi i Inxhinierisë ushqimore është drejtim multiinstitucional dhe multidisiplinar, andaj arsyeja e komisionit për pranimin e këtyre studentëve nuk qëndron. Bazuar në këtë, rektori vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore;
3. Fakultetit të Edukimit;
4. Zyrës për çështje të studentëve;
5. Zyrës së TI-së;
6. Anëtarëve të Komisionit;
7. Zyrës ligjore.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Rektori i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1329
Dt 26.10.2015

Në bazë të nenit 49 dhe në lidhje më nenin 104, 109 dhe 111 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM

për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve master për vitin akademik 2015-2016

- I. Studentët e Universitetit të Mitrovicës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve master për vitin akademik 2015-2016, nëse arrijnë kalueshmërinë e 40 % të provimeve nga viti paraprak.
- II. Studentët nuk mund ti nënshtrohen provimeve të vitit të dytë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të parë.
- III. Provimet për studimet master mbahen gjatë afatit të provimeve. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit), si dhe afatet të cilat lejohen me vendime të veçanta të Senatit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe është i vlefshëm për vitin akademik 2015-2016.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it
2. Dekanëve të fakulteteve
3. Zyrtarit ligjor



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit të UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1330
Dt 26.10.2015

Në bazë të nenit 49 dhe në lidhje me nenin 122,123,129,130 dhe 131 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM

Për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore-bachelor për vitin akademik 2015-2016.

I

Studentët e Universitetit të Mitrovicës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve nëse i plotësojnë këto kushte:

- a) Vitin e dytë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët kanë fituar 70% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të parë të studimeve.
- b) Përjashtimisht, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike-Drejtimi Inxhinieri Ekonomike mund ta regjistrojnë vitin e dytë me më së paku 7 (shtatë) provime të dhëna në vitin e parë.
- c) Vitin e tretë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar 40% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.
- d) Vitin e katërt të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar 30% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të tretë të studimeve.

II

Studenti është i obliguar që në vitin pasardhës t'i japë paraprakisht provimet e mbetura nga vitin paraprak e pastaj të fillojë dhënien e provimeve në vitin, në të cilin është i regjistruar.

III

Ndërrimi i programit të studimeve- i lejohe studentit që të fillojë program të ri të studimeve, nëse së paku 50% të provimeve, përkatësisht të kredive i ka dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.

Studentit mund t'i lejohe që të regjistrohe në programin e ri të studimeve më së paku në vitin e dytë të studimeve.

Ndërrimi i programeve mund të lejohe deri në 5% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në Degën përkatëse të Fakultetit.

IV

Ngjashëm me paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës III të këtij vendimi, mund të lejohe edhe transferimi i studentëve nga Universitetet e tjera të akredituara në Universitetin e Mitrovicës.

V

Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohe kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr Këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv, student do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.


VI

Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi student t'i ketë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe, student duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.

Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekan i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit. Studenti, i cili një vit pas përfundimit të semestrit të fundit nuk i përfundon studimet, sërish e regjistron vitin e studimeve me pagesë.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Dekanëve të njësisë akademike;
3. Sekretarëve të fakulteteve;
4. Sekretarit të përgjithshëm;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Rektori i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1332
Dt 26.10.2015

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM


- I. Për lejimin e angazhimeve shtesë në fakultetet e UMIB-it.
- II. Dekanët, përkatësisht koordinatorët e njësive akademike janë të obliguar që të sjellin te prorektori për mësimdhënie, kërkime shkencore dhe ëështje të studentëve, listat me emrat dhe lëndët e personelit shtesë të angazhuar.
- III. Angazhimet shtesë do të bëhen nga lista e kandidatëve që kanë aplikuar në kuadër të konkursit plotësues të datës 22.9.2015, e që i plotësojnë kriteret në bazë të këtij konkursi.


Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, pasi shqyrtoi kërkesën e dekanëve, përkatësisht koordinatorëve të njësive akademike për lejimin e angazhimit shtesë për disa lëndë, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, sepse në të kundërt do të pamundësohet mbarëvajtja e procesit mësimor. Bazuar në këtë, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve
3. Zyrës së personelit;
4. Zyrës së TI-së;
5. Anëtarëve të Komisionit;
6. Zyrës ligjore.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it





UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1345
Dt 28.10.2015

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM

- I. Për shpalljen e konkursit për rizgjedhje-avansim të personelit akademik në njësitë akademike të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", sipas propozimeve të njëjësive akademike.
- II. Konkursi për zgjedhjen e personelit akademik në njësitë akademike të UMIB-it do të hartohet në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit.
- III. Pjesë e këtij vendimi është edhe konkursi i hartuar në bazë të propozimit të njëjësive akademike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1346
Dt 28.10.2015

Në bazë të nenin 48 dhe 153 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike për zgjedhjen e një asistenti sipas konkursit të shpallur më 30.6.2015 për pozitën: Një asistent për lëndët: Mikroekonomi dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore, Makroekonomi, Biznes ndërkombëtar, Marketing, Parimet e kontabilitetit, Analizë financiare, Menaxhim, Kontabilitet Kosto dhe Auditim.
- II. Bazuar në nenin 153 pika 2 dhe 3 të Statutit të Përkohshëm të UMIB – it, Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike është i obliguar që të bëjë rishqyrtimin e propozimit për zgjedhjen e një asistenti për pozitën si në pikën 1 të këtij vendimi.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pasi shqyrtoi propozimet e Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike dhe të Komisionit të Studimeve për zgjedhjen e personelit akademik sipas konkursit të shpallur më 30.6.2015 për pozitën: Një asistent për lëndët: Mikroekonomi dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore, Makroekonomi, Biznes ndërkombëtar, Marketing, Parimet e kontabilitetit, Analizë financiare, Menaxhim, Kontabilitet Kosto dhe Auditim, e konsideroi të arsyeshme që të rishqyrtohen edhe një herë aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë, pasi Komisioni i Studime konsideron se në mesin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë ka kandidatë më të thirrur se sa kandidati i propozuar. Bazuar në këtë, Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1347

Dt 28.10.2015

Në bazë të nenin 48, 153 dhe 159 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2015, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet propozimi i Komisionit recensues për zgjedhjen e një asistenti sipas konkursit të shpallur më 30.6.2015 për pozitën: Një asistent për grup lëndësh nga lëmi penal.
- II. Bazuar në nenin 153 pika 2 dhe 3 të Statutit të Përkohshëm të UMIB – it, Komisioni recensues është i obliguar që të bëjë rishqyrtimin e propozimit për zgjedhjen e një asistenti për pozitën si në pikën I të këtij vendimi.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pasi shqyrtoi propozimet e Komisionit recensues dhe të Komisionit të Studimeve për zgjedhjen e personelit akademik sipas konkursit të shpallur më 30.6.2015 për pozitën: Një asistent për grup lëndësh nga lëmi penal, e konsideroi të arsyeshme që të rishqyrtohen edhe një herë aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë, pasi Komisioni i Studime konsideron se në mesin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë ka kandidatë më të thirrur se sa kandidati i propozuar, ndërsa kandidati i propozuar nuk i plotëson kriteret në bazë të Statutit të Universitetit. Bazuar në këtë, Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it